



AGJENCIA PËR MBIKËQYRJEN E SIGURIMEVE

RAPORTI VJETOR
MBI GJENDJEN DHE LËVIZJEN NË TREGUN E SIGURIMEVE NË VITIN 2019

Shkup, 2020

Raporti është përgatitur në përputhje me nenin 158-o të Ligjit për mbikëqyrje të sigurimeve dhe për përgatitjen e tij Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka përdorur të dhëna nga evidenca personale.

PËRMBAJTJA

1. HYRJA	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
2. KORNIZA LIGJORE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3. TREGU I SIGURIMEVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË.....	7
3.1. SHOQËRITË E SIGURIMEVE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1.1. STRUKTURA E PRONËSISË	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1.2. NORMA E ZHVILLIMIT	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1.3. PRIMI I SHKRUAR BRUTO	10
3.1.4. STRUKTURA E PJESËMARRJES	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1.5. DËME BRUTO TË PAGUARA	16
3.1.6. MJETE DHE BURIME TË MJETEVE.....	17
3.1.7. REZERVA TEKNIKE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1.8. MJETE TË CILAT I MBULOJNË REZERVAT TEKNIKE.....	21
3.1.9. ADEKUATSHMËRIA E KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE.....	22
3.1.10. REZULTATI FINANCIAR NGA PUNA	23
3.1.11. INDIKATORË PËR SEKTORIN E SIGURIMEVE	24
3.2. NDËRMJETËSIMI NË SIGURIMET	26
3.2.1. PËRFAQËSIMI NË SIGURIMET.....	26
3.2.1. AKTIVITETE TË BROKERIMIT TË SIGURIMEVE	28
3.3. BYROJA NACIONALE E SIGURIMEVE	30
3.3.1. FONDI GARANTUES NË BNS.....	30
3.3.2. RIMBURSIMI I DËMEVE NGA FONDI GARANTUES.....	32

1. HYRJA

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm "AMS") është trup rregullator i pavarur dhe sovran në tregun e sigurimeve i cili kryen autorizime publike të përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrjen e sigurimeve dhe Ligjin për sigurime të obligueshëm në transport. AMS-ja ka për qëllim të kontribuojë në funksionimin e ligjshëm dhe efikas të tregut të sigurimeve në vend, në zhvillimin e vazhdueshëm të tij, në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të siguruarve, si edhe në përparimin e stabilitetit financiar në vend.

Në fund të vitit 2019 në tregun e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut punojnë aktivisht 16 shoqëri sigurimesh, prej të cilave 11 shoqëri kryejnë punë të sigurimeve jo-jetë, kurse 5 sigurime të jetës. Në fushën e ndërmjetësimit, në fund të vitit 2019 aktive janë 39 shoqëri brokerimi në sigurime, 10 shoqëri për përfaqësim në sigurime dhe 7 banka të cilat kryejnë punë të përfaqësimit në sigurime.

Në vitin 2019 është realizuar primi i shkruar bruto (në tekstin e mëtejshëm: "PSHB") në shumë të përgjithshme prej 10.58 miliarda denarësh, që përbën një rritje prej 6,61% në raport me PSHB-në e realizuar në vitin 2018 (2018: 9.93 miliarda denarë). Në pjesën e sigurimit jo-jetë është realizuar PSHB në shumë prej 8,75 miliarda denarësh (2018: 8.26 miliarda denarë), përkatësisht rritje prej 5.99% në krahasim me vitin 2018. Njëkohësisht, te sigurimi i jetës është realizuar PSHB-ja në shumë prej 1.83 miliarda denarësh (2018: 1.67 miliarda denarë), që përbën zmadhim prej 9,69%.

Shoqëritë e Sigurimeve më 31.12.2019 disponojnë mjete në shumë prej 23.92 miliarda denarësh, që shënojnë rritje prej 10.53% në raport me vitin e kaluar (2018: 21,64 miliarda denarë). Kapitali i përgjithshëm i llogaritur i shoqërive të sigurimeve shënon rritje prej 5,22% në krahasim me vitin 2018, përkatësisht në fund të vitit 2019 është 6,65 miliarda denarë. Margjina e solvencës, si indikator kryesor për vlerësim të stabilitetit të sektorit të sigurimeve është 1,69 miliarda denarë, kështu që kapitali i sektorit të sigurimeve është 3.9 herë mbi nivelin e margjinës së solvencës.

Gjatë vitit 2019, sektori i sigurimeve realizoi humbje prej 25.36 milionë denarësh. Gjatë kësaj, shoqëritë e sigurimeve jo-jetë realizuan humbje prej 125.91 milionë denarësh, kurse, shoqëritë e sigurimeve të jetës realizoi fitim për tatim prej 100.54 milionë denarësh.

Në fushën e normativës ligjore në vitin 2019 janë miratuar ndryshime në Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve dhe Ligjin për sigurim të obligueshëm në transport.

2. KORNIZA LIGJORE

Ligji për mbikëqyrje të sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2002, 98/02, 79/07, 88/08, 67/10, 44/11, 112/11, 188/13, 30/14, 43/14, 112/14, 153/15, 92/15, 23/16, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19), Ligji për sigurime të obligueshëm në transport ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 88/05, 70/06, 81/08, 47/11, 135/11, 112/14 dhe 145/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19), Ligji për sigurime vullnetare shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/12 dhe 192/15), Ligji për pagim të pensioneve dhe kompensimeve pensionale në fushën e sigurimit financiar kapital të pensionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/12, 147/15 dhe 30/16) dhe Ligji për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 275/19) dhe kornizën ligjore themelore e cila i rregullon kushtet dhe mënyrën e kryerjes së punëve të ndërmjetësimit në sigurime dhe zbatimin e supervizionit mbi punën e shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit të sigurimeve dhe shoqërive për përfaqësime në sigurime.

Kornizën më të gjerë ligjore e përfaqësojnë Ligji për marrëdhënie obligative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/01, 4/02, 5/03, 84/08, 81/09, 161/09 dhe 123/13) në pjesën që lidhet me marrëveshjet e sigurimeve dhe Ligji për shoqëritë tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 187/13, 38/14, 41/14, 138/14, 88/15, 192/15, 6/16, 30/16 dhe 61/16, 64/18 и 120/18).

Ligji për mbikëqyrje të sigurimeve i inkorporon parimet dhe standardet e sigurimeve të Asociacionit Ndërkombëtar të Supervizorëve të Sigurimeve (IAIS), si dhe direktivat për sigurime të Bashkimit Evropian (BE). Me këtë ligj rregullohet themelimi dhe puna e shoqërive të sigurimeve, menaxhimi me rreziqet, roli i aktuarëve të autorizuar, mbajtja e librave të biznesit dhe raporteve, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, përfaqësimi dhe ndërmjetësimi në sigurimet, supervizioni i shoqërive të sigurimeve, puna e AMS-së, zbatimi i mbikëqyrjes dhe procedura për marrjen e vendimeve nga AMS-ja, puna e pulleve të sigurimeve dhe risigurimeve, bashkëpunimi me organet dhe trupat mbikëqyrës të BE-së, si dhe dispozitat ndëshkuese.

Në vitin 2019 është miratuar Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbikëqyrje të sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 101/2019) me të cilin hiqet kufizimi për themeluesit e shoqërive për përfaqësim në sigurime që të jenë të lidhur nga kapitali apo në aspektin drejtues me shoqëritë e sigurimeve, përkatësisht, shoqëria për përfaqësim në sigurime të mos lejohet të jetë person që lidhet me shoqëri sigurimi. Ndryshimet e Ligjit kanë për qëllim të mundësojnë qasje më të madhe të prodhimit dhe shërbimit e sigurimeve nëpërmjet përfaqësimit në sigurime si kanal i shpërndarjes së prodhimeve dhe shërbimeve të sigurimit.

Sigurimi i obliguar në transport është rregulluar me **Ligjin për sigurim të obliguar në transport**, i cili i rregullon marrëveshjet për sigurim të obliguar, shumat minimale të sigurimeve, afatet për paraqitje dhe kompensim të dëmit nga shoqëritë e sigurimeve, përcaktimi i të drejtës së ndërmjetësimit (mediatim), kompetencat e Fondit Garantues, ndryshimi i mënyrës së përcaktimit të tarifave të primeve nëpërmjet funksionimit të Komisionit për Sigurim të Përgjegjësishë Automobilistike dhe Dispozitat Ndëshkuese për Shoqëritë e Sigurimeve dhe Byrosë Nacionale për Sigurimet. Gjithashtu, Ligji parashikon lehtësim të dhënies së shërbimeve ndërkufitare të sigurimeve nëpërmjet vendosjes

të së a.q. përfaqësues i autorizuar për dëmet dhe vendosjes së Shërbimit për kompensim të dëmeve, por këto aktivitete do të aktualizohen në momentin e hyrjes së Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Në vitin 2019 është miratuar Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim të obliguar në transport ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19) me qëllim të harmonizimit me dispozitat e BE-së në fushën e aviacionit civil, përkatësisht vendoset sigurim i obliguar i bagazhit dhe sendeve, dëme që u shkaktohen personave të tretë nga mjet i aviacionit pa ekuipazh, si dhe sigurim për dëm të shkaktuar ndaj udhëtarëve gjatë operacioneve jokomerciale me mjete të aviacionit. Gjithashtu, me ndryshimet përmirësohen të drejtat e personave të dëmtuar gjatë aksidenteve rrugore, në drejtim të përshpejtimit të procesit të dëmshpërblimit duke u vendosur afati prej 60 ditësh gjatë së cilit shoqëria përgjegjëse e sigurimeve është e obliguar personit të dëmtuar t'i dorëzojë ofertë të argumentuar për kompensim të dëmit apo përgjigje të argumentuar për kërkesën për kompensim të dëmit.

Me **Ligjin për sigurim vullnetar shëndetësor** jepet mundësi ligjore dhe hapet një fushë e gjerë veprimi për shoqëritë e sigurimeve për oferta të pakove të shërbimeve shëndetësore të cilat janë përfshirë tashmë me sistemin e sigurimit të obligueshëm shëndetësor. Sigurimi shtesë shëndetësor siguron mbulim të shpenzimeve në emër të pjesëmarrjes me mjete personale për shfrytëzim të shërbimeve shëndetësore nga sigurimi shëndetësor i obliguar (participim), në përputhje me dispozitat e sigurimit të obliguar shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore. Sigurimi privat shëndetësor mundëson mbulim të shpenzimeve për përdorim të shërbimeve shëndetësore për standard më të lartë të shërbimeve shëndetësore të cilat dalin nga sigurimi i obliguar shëndetësor, shpenzimet për mbulim të shërbimeve shëndetësore të përdorura në veprimtari shtesë, si dhe për përdorim të shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore jashtë rrjetit të institucioneve shëndetësore ku kryhet veprimtaria shëndetësore dhe te personat juridikë të cilët kryejnë përpunim, dhënie dhe servisim të mjeteve ortopedike dhe mjeteve të tjera ndihmëse.

Me **Ligjin për pagim të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga fusha e sigurimit financiar pensional** përfundoi rregullimi i sigurimit kapital financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me rregullim të fazës së deakumulimit, përkatësisht me këtë Ligj rregullohen pagesat e pensioneve nga shtylla e dytë dhe kompensimet e pensionit nga shtylla e tretë (tërheqje të programuara, anuitete të përjetshme dhe kombinimi i tyre), llojet e pagesave të kompensimeve të pensionit nga shtylla e tretë (tërheqje të programuara, anuitete, pagesa të njëfishta dhe të shumëfishta), karakteristika dhe rregulla për lloje të ndryshme të pagesave dhe mënyra dhe procedura e fitimit të të drejtës së kompensimit pensional nga shtylla e tretë. Në këtë Ligj rregullohet edhe se cilat institucione do të mund të bëjnë pagim të pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga shtylla e dytë dhe e tretë - shoqëritë pensionale dhe shoqëritë për sigurim të jetës. Gjithashtu, për shkak të transparencës më të madhe të përzgjedhjes së pensionit nga shtylla e dytë dhe kompensimit të pensionit nga shtylla e tretë, u vendos Sistem elektronik i centralizuar i kotacionit nëpërmjet të cilit do të dorëzohen kërkesa për kotacione për lloje të ndryshme të pagesave dhe do të merren oferta nga shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimeve.

Ligji për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përcakton kompetencë të AMS-së për zbatim të mbikëqyrjes në tregun e sigurimeve, i cili është lëndë rregullimi në këtë ligj, ndërsa sidomos në pjesën e zbatimit të masave dhe veprimeve për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3. TREGU I SIGURIMEVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

3.1. SHOQËRITË E SIGURIMEVE

Gjatë vitit 2019 në tregun e sigurimeve funksionojnë 16 shoqëri sigurimesh për sigurim, prej të cilave 5 shoqëri të sigurimeve punojnë në sigurimin e jetës, kurse 11 të tjerat kryejnë punë të sigurimit jo-jetë. Vetëm një shoqëri, përveç punëve të sigurimit jo-jetë, ka lehtë të kryejë edhe punë të risigurimit. (Tabela nr. 1).

Tabela nr. 1: Regjistri i shoqërive për sigurim

	Emri i shoqërisë	Grupi i sigurimeve
1	SHA për sigurim dhe risigurim MAQEDONIA - Shkup, Vjena Inshurens Grup	Sigurimi jo-jetë dhe risigurimi
2	TRIGLLAV OSIGURUVANJE SHA Shkup	Sigurim jo-jetë
3	SAVA OSIGURUVANJE SHA Shkup	
4	SHA e sigurimeve EVROINS Shkup	
5	SHA e sigurimeve WINER – VIENNA INSURANCE GROUP SHA	
6	SHA e sigurimeve EUROLINK Shkup	
7	GRAVE OSIGURUVANJE Jo-jetë SHA Shkup	
8	Shoqëri e sigurimeve UNIKA SHA Shkup	
9	Grupacioni nacional i sigurimeve OSIGURITELNA POLISA SHA Shkup	
10	HALK OSIGURUVANJE SHA Shkup	
11	KROACIJA OSIGURUVANJE SHA- Shoqëri e sigurimeve jo-jetë	
12	KROACIJA OSIGURUVANJE SHA - Shoqëri e sigurimeve të jetës	Sigurim i jetës
13	GRAVE osiguruvanje SHA Shkup	
14	SHA e sigurimeve WINER Lajf– VIENNA INSURANCE GROUP Shkup	
15	Shoqëria e sigurimeve UNIKA Lajf SHA Shkup	
16	Trigllav Osiguruvanje Jetë SHA Shkup	

Burimi: AMS

Në vitin 2019 ndodhën 2 ndërmarrje të shoqërive për sigurime jo-jetë. Ndërmarrja e parë ishte e shoqërisë të sigurimeve jo-jetë Nova osiguruvanje SHA Shkup nga Hallk Banka SHA Shkup, pjesë e grupacionit financiar turk që në portofolin e vet, posedon, gjithashtu, shoqëri sigurimesh. Transaksioni është zbatuar më 08.01.2019, me Vendim për dhënie të miratimit për fitim të pjesëmarrjes së kualifikuar të Hallk Bankës SHA Shkup në Nova Osiguruvanje SHA Shkup më 24.12.2018. Pas ndërmarrjes, shoqëria punon me emrin e ri Hallk osiguruvanje SHA Shkup.

Ndërmarrja e dytë është për shoqërinë e sigurimeve jo-jetë Eurosig SHA Shkup nga grupacioni austriak i sigurimeve GRAVE. Transaksioni është zbatuar më 08.07.2019, me Vendim për dhënie të miratimit për fitim të pjesëmarrjes së kualifikuar të grupacionit të sigurimeve GRAVE nga Austria më 27.05.2019. Pas ndërmarrjes, shoqëria punon me emrin e ri GRAVE Osiguruvanje Jo-jetë SHA Shkup.

Të dy ndërmarrjet i konsiderojmë si njohje për tregun funksional ekzistues të sigurimeve dhe njëkohësisht si trend pozitiv, duke pasur parasysh se në tregun vendas janë tërheqëse grupacionet e sigurimeve me traditë të madhe, që nënkupton kushte më të mira sigurimi për qytetarët dhe ekonominë.

Shoqëritë e sigurimeve deri në fund të vitit 2019 punësojnë 1.948 të punësuar, që përbën një numër pothuajse të pandryshuar të fuqisë së angazhuar të punës në raport me vitin 2018 (2018: 1.949).

3.1.1. Struktura e pronësisë

Shoqëritë e sigurimeve janë në pronësi dominuese të personave juridikë të jashtëm nga sektori financiar (79,51%), të cilët janë pjesërisht apo tërësisht të pranishëm në 14 nga 16 shoqëritë e sigurimeve në treg (Tabela nr. 2). Gjatë kësaj, 12 shoqëri të sigurimeve janë pjesë e grupacioneve të sigurimeve me seli në vendet anëtare të BE-së, kurse dy shoqëri sigurimesh janë në pronësi të tërësishtme të investuesve vendas.

Tabela nr. 2: Struktura e pronësisë së shoqërive të sigurimeve (përqindje)

	2019	2018	2017
1. Aksionarë të huaj	79,51%	87,29%	87,07%
1.1. Persona fizikë	0,04%	0,05%	0,05%
1.2. Persona juridikë jofinanciarë	0,00%	0,00%	0,00%
1.3. Institucione financiare	79,46%	87,24%	87,01%
2. Aksionarë vendas	20,46%	12,67%	12,90%
2.1. Persona fizikë	4,97%	5,86%	6,08%
2.2. Persona juridikë jofinanciarë	0,91%	5,10%	5,09%
2.3. Institucione financiare	14,58%	1,72%	1,72%
3. Shteti	0,03%	0,04%	0,04%
GJITHSEJ	100,00%	100,00%	100,00%

Burimi: AMS


3.1.2. Norma e zhvillimit

Treguesit themelorë me të cilët matet norma e zhvillimit të tregut të sigurimeve janë norma e penetrimit dhe norma e dendësisë¹. Të dhënat për nivelin e penetrimit të sigurimeve në vitin 2019 dëshmuar se PSHB-ja e përgjithshme në vend merr pjesë me 1.52% në prodhimin bruto vendas (2018: 1,50%), kurse norma e dendësisë është 5.095 denarë për banor², me të cilën është arritur rritje prej 6,51% në raport me vitin e kaluar (Grafiku nr. 1).

Grafiku nr.1: Tregues të zhvillimit të tregut të sigurimeve (milionë denarë; boshti djathtas - përqindje)

¹Norma e penetrimit llogaritet si raport i primit të shkruar bruto dhe prodhimit bruto vendas, kurse norma e dendësisë llogaritet si raport i primit të shkruar bruto dhe numrit të banorë në vend.

²E dhëna për numrin e banorëve është për vitin 2018, si e dhëna e fundit e shpallur për popullatën nga ESHS-ja.



Burimi: AMS, Enti Shtetëror i Statistikës dhe Ministria e Financave

Sektori i sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, karakterizohet nga përqendrimi i ulët që është parakusht për konkurrencë funksionale të tregut. Indeksi herfindal, i llogaritur nëpërmjet PSHB- -së në vitin 2019 është 792,42 (2018: 830,10). Rezultat të ngjashëm dëshmon edhe matja e indeksit nëpërmjet mjeteve të shoqërive të sigurimeve -821,71 në 2019 vitin (2018: 827,41)³.

Duke u analizuar sipas grupeve të sigurimeve, përqendrimi më i lartë është te sigurimi i jetës, për shkak të numrit të vogël të shoqërive në këtë fushë. Te shoqëritë e sigurimit të jetës Indeksi herfindal, i matur sipas PSHB- -së është 3.157,74(2018:3.374,55), kurse, i matur sipas mjeteve të shoqërive është 3.083,30(2018:3.085,58).

Te sigurimi jo-jetë treguesit dëshmojnë përqendrim më të vogël, ku matja nëpërmjet Indeksit herfindal sipas PSHB-së në vitin 2019 është 1.020,43 (2018: 1.061,77) dhe dëshmon zvogëlim në raport me vitin e kaluar, kur i njëjti tregues i matur nëpërmjet mjeteve të shoqërive është 1.058,79 (2018: 1.097,37).

Treguesi CR5⁴, i matur nëpërmjet pjesëmarrjes në PSHB, te shoqëritë për sigurime jo-jetë, në vitin 2019 shënon zvogëlim dhe është 57,99%(2018: 60,67%).

Në vijim jepen tabela ku tregohen lëvizjet e Indeksit Herfindal dhe treguesi i përqendrimit të pesë shoqërive të para të sigurimeve(CR5):

Tabela nr. 3: Indeksi herfindal dhe treguesi CR5 sipas PSHB- -së

	2019		2018		2017	
	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5
I gjithë sektori	792,42	47,87%	830,10	50,46%	823,65	53,56%
Jo-jetë	1.020,43	57,99%	1.061,77	60,67%	1121,64	64,26%

³Indeksi herfindal llogaritet me formulën:

$$HI = \sum_{i=1}^n (S)_i^2$$

ku S është pjesëmarrja e çdo shoqërie të sigurimeve në mjetet e përgjithshme (primit i shkruar bruto) të sektorit të sigurimeve, kurse n është numri i përgjithshëm i sigurimeve në segmentin përkatës. Kurse indeksi lëviz në interval nga 1.000 njësi deri në 1800 njësi, niveli i përqendrimit të sektorit të sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

⁴Treguesi CR5 është pjesëmarrja e 5 shoqërive të sigurimeve me pjesëmarrjen më të madhe në strukturën e përgjithshme.

Jetë	3.157,74	100,00%	3.374,55	100,00%	3.040,90	100,00%
-------------	----------	---------	----------	---------	----------	---------

Burimi: AMS


Tabela nr. 4: Indeksi herfindal dhe treguesi CR5 i matur sipas mjeteve

	2019		2018		2017	
	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5
I gjithë sektori	821,71	53,50%	827,41	53,86%	836,45	51,02%
Jo-jetë	1.058,79	60,64%	1.097,37	62,15%	1063,94	60,79%
Jetë	3.083,30	100,00%	3.085,58	100,00%	3.371,13	100,00%

Burimi: AMS

Në fund të vitit 2019, në domenin e përqendrimit tregtar në pjesën e sigurimit jojetë, 4 shoqëri sigurimesh e tejkalojnë pragun e pjesëmarrjes me mbi 100% në PSHB-në e përgjithshme. Kështu, në tregun e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut asnjë shoqëri nuk e kalon pragun mbi 20% pjesëmarrje në këtë treg (Grafiku nr. 2).

Grafiku nr. 2: Përqendrimi i tregut sipas primit të shkruar bruto në vitin 2019, në grupin e sigurimeve jo-jetë (përqindje)



Burimi: AMS

Në grupin e sigurimit jetësor, pjesëmarrje dominuese kanë dy shoqëri të sigurimit të jetës (Grafiku nr. 3).

Grafiku nr. 3: Përqendrimi i tregut sipas primit bruto polisë në vitin 2019, në grupin e sigurimit të jetës (përqindje).



Burimi: AMS

3.1.3. Primi i shkruar bruto

PSHB-ja në sigurime dhe risigurime të shoqëritë e sigurimeve jo-jetë i përfshijnë të gjitha shumat e primit të cilat janë dakorduar (polisa) gjatë periudhës aktuale kontabiliste pa dallim, nëse ato kanë të bëjnë pjesërisht apo tërësisht me periudhën e ardhshme, kurse të sigurimi i jetës primi i përgjithshëm i shkruar i përfshin të gjitha primet e paguara deri në fund të periudhës së kontabilitetit.

Në vitin 2019 është realizuar PSHB në shumë të përgjithshme prej 10,58 miliarda denarësh (Tabela nr. 5), që përbën rritje prej 6,61% në raport me PSHB- në e realizuar në vitin 2018 (2018: 9,93 miliarda denarë).

Tabela nr. 5: Primi i shkruar bruto sipas klasave të sigurimeve (mijë denarë)

Klasa e sigurimit	PRIMI I SHKRUAR BRUTO (PSHB)		DINAM IKA	PJESËMARRJA NË PSHB-në E PËRGJITHSHME	
	2019	2018	19/18	2019	2018
01. Sigurimi i aksidenteve	694.160	680.256	2,04%	6,56%	6,85%
02. Sigurimi shëndetësor	188.885	125.709	50,26%	1,78%	1,27%
03. Sigurimi i mjeteve motorike - kasko	838.236	797.324	5,13%	7,92%	8,03%
05. Sigurimi i mjeteve ajrore - kasko	53.321	29.221	82,47%	0,50%	0,29%
06. Sigurimi i objekteve lundruese - kasko	565	684	-17,40%	0,01%	0,01%
07. Sigurimi i mallrave në transport - kargo	81.562	78.947	3,31%	0,77%	0,80%
08. Sigurimi i pronës nga zjarri	751.603	587.019	28,04%	7,10%	5,91%
09. Sigurime të tjera të pronave	1.020.798	1.131.792	-9,81%	9,65%	11,40%
10. Autopërgjegjësi	4.577.080	4.313.885	6,10%	43,25%	43,45%
11. Sigurimi i përgjegjësisë të përdorimit të mjeteve të avionit	14.336	6.669	114,96%	0,14%	0,07%
12. Sigurimi i përgjegjësisë të përdorimit të objekteve lundruese	3.063	2.635	16,24%	0,03%	0,03%
13. Sigurimet e tjera nga përgjegjësia	226.948	212.179	6,96%	2,14%	2,14%
14. Kredi	12.927	3.523	266,93%	0,12%	0,04%
15. Sigurime të garancive	1241	5.249	-76,36%	0,01%	0,05%
16. Sigurime nga humbjet financiare	67.203	69.589	-3,43%	0,63%	0,70%
17. Sigurimi i mbrojtjes ligjore	5	12	-58,33%	0,00%	0,00%
18. Sigurimi i asistencës turistike	220.692	212.994	3,61%	2,09%	2,15%
19. Sigurimi i jetës	1.603.231	1.502.400	6,71%	15,15%	15,13%
20. Sigurimi martesë- lindje	1.020	889	/	0,01%	/
21. Sigurimi i jetës kur rrezikun e investimit e merr përsipër i siguruari	226.538	166.589	35,99%	2,14%	1,68%
GJITHSEJ	10.583.414	9.927.565	6,61%	100,00%	99,99%
GJITHSEJ JO-JETË	8.752.625	8.257.687	5,99%	82,70%	83,18%
GJITHSEJ JETË	1.830.789	1.668.989	9,69%	17,30%	16,81%

Burimi: AMS

Trendi pozitiv është i pranishëm në të dy segmentet e sigurimit, por në pjesën e sigurimit jo-jetë është realizuar PSHB në shumë prej 8,75 miliarda denarësh (2018: 8,26 miliarda denarë), ose ajo është 82,70% e PSHP-së së përgjithshme të sektorit të sigurimeve dhe përfaqëson një rritje prej 5,99% në krahasim me vitin 2018. Gjatë vitit 2019 nuk është realizuar primi për risigurim (2018: 110,2 mijë denarësh).

Individualisht, në krahasim me vitin 2018, rritje e PSHB -së është vënë re te 9 shoqëri të sigurimeve jo-jetë (Tabela nr. 6).

Tabela nr. 6: Primi i shkruar bruto sipas shoqërive të sigurimit jo-jetë (mijë denarë)

NR.	Shoqëri sigurimesh	Primi i shkruar bruto (PSHB)		Dinamika 19/18	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
		2019	2018		2019	2018
1	TRIGLLAV	1.424.892	1.425.500	-0,04%	16,28%	17,26%
2	EUROLINK	1.013.069	1.067.959	-5,14%	11,57%	12,93%
3	MAQEDONIA	927.978	910.677	1,90%	10,60%	11,03%
4	SAVA	886.426	802.983	10,39%	10,13%	9,72%
5	UNIKA	823.176	802.822	2,54%	9,40%	9,72%
6	WINER	808.989	770.222	5,03%	9,24%	9,33%
7	EVROINS	813.562	674.725	20,58%	9,30%	8,17%
8	OSIGURITELNA POLISA	710.064	700.761	1,33%	8,11%	8,49%
9	KROACIA JO-JETË	459.102	422.124	8,76%	5,25%	5,11%
10	HALK	523.287	344.200	52,03%	5,98%	4,17%
11	GRAVE JO-JETË	362.080	335.713	7,85%	4,14%	4,07%
	GJITHSEJ JO-JETË	8.752.625	8.257.686	5,99%	100,00%	100,00%

Burimi: AMS

Në pjesën e sigurimit të jetës, që përfaqëson 17,30% të PSHB-së së përgjithshme të sektorit të sigurimeve, është realizuar PSHB në shumë prej 1,83 miliarda denarësh (2018: 1,67 miliarda denarë), që përbën rritje prej 9,69% në raport me vitin 2018.

Individualisht në krahasim me vitin 2018, rritja e PSHB-së është vërejtur te të gjitha shoqëritë e sigurimit të jetës (Tabela nr. 7).

Tabela nr. 7: Primi i shkruar bruto sipas shoqërive të sigurimeve të jetës (mijë denarë)

NR.	Shoqëri sigurimesh	Primi i shkruar bruto (PSHB)		Dinamika 19/18	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
		2019	2018		2019	2018
1	KROACIA JETË	805.885	771.270	4,49%	44,02%	46,19%
2	GRAVE	548.376	514.037	6,68%	29,95%	30,78%
3	WINER JETË	291.559	268.454	8,61%	15,93%	16,08%
4	UNIKA JETË	147.842	97.374	51,83%	8,08%	5,83%
5	TRIGLAV JETË	37.127	18.743	0,00%	2,03%	1,12%
	GJITHSEJ JETË	1.830.789	1.669.878	9,64%	100,00%	100,00%

Burimi: AMS

Një nga treguesit më kompetentë për vëllimin e aktiviteteve të kryera të shoqërive të sigurimeve është analiza e vëllimit të aktiviteteve të kryera sipas klasave të ndryshme të sigurimit. Në këtë mënyrë të dhënat për PSHB-në sipas klasave të sigurimit, në mënyrë plotësuese është treguar struktura e tregut e të gjitha shoqërive të sigurimeve në vitin 2019 (Tabela nr. 8).

Tabela nr. 7: Primi i shkruar bruto për periudhën 01.01.2019- 31.12.2019 (mijë denarë)


	Maqedonia	Trigllav	Sava	Evroins	Eurolink	Winer	Grave jojetë	Unika	Osiguritelnaolisë Polisa	Hallk	Kroacia	
01. Aksidetnei	91.910	95.588	87.207	33.169	133.592	66.428	15.775	61.822	42.401	19.808	46.460	694.160
02. Sigurimi shëndetësori	2284	71.380	8.926	10648	86.766	2.491	0	6.249	141	0	0	188.885
03. Kasko mjete motorike	66.560	170.725	136.847	62.695	94.218	48.153	12.123	57.818	102.003	34.216	52.878	838.236
04. Kasko mjete në shina	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
05. Kasko mjete ajrore	0	37738	0	0	7.235	8.348	0	0	0	0	0	53.321
06. Kasko objekte lundruese	6	143	148	26	106	78	0	36	22	0	0	565
07. Kargo	24.669	20.778	4.931	12.188	5.740	5.688	16	5.144	956	178	1.274	81.562
08. Prona nga zjarri dhe rreziqet e tjera	128.760	76.456	55.893	174.875	100.121	15.559	3.953	77.798	37.298	31.253	49.637	751.603
09. Prona të tjera	272.348	222.855	106.674	82.512	66.510	107.088	2.043	61.543	15.614	67.008	16.603	1.020.798
10. PA (Gjithsej)	281.631	581.758	433.668	411.470	416.215	525.043	321.474	501.943	475.728	358.910	269.240	4.577.080
11. Përgjegjësi aviacioni	0	8875	0	0	2.647	2.515	0	0	299	0	0	
13. Përgjegjësi e përgjithshme	36.771	41.201	11.657	12.197	61.499	12.832	690	24.997	15.199	5.580	4.325	
15. Garanci	9	62	830	126	135	0	0	0	79	0	0	
17. Mbrojtje ligjore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5	
19. Jetë	768.266	543.843	148.964	105.031	37.127							
21. Sigurimi i jetës kur rrezikun investimit e merr përsipër i siguruari	37619	4533	142595	41791	0							

Burimi: AMS

3.1.4. Struktura e pjesëmarrjes

Në PSHB-në e përgjithshme pjesëmarrje më të rëndësishme ka sigurimi i mjeteve motorike me 51,17% (2018: 51,49) që përbëhet nga sigurimi obligues dominues nga përgjegjësia automobilistike (PA), që merr pjesë me 43,25% (2018: 43,45%), dhe nga sigurimi vullnetar i mjeteve automobilistike (kasko) që merr pjesë me 7,92%(2018: 8,03%). Një vend të rëndësishëm në strukturën e PSHB-së merr sigurimi i pronës me 16,75% (2018: 17,31%), sigurimi i jetës me pjesëmarrje prej 17,30% (2018: 16,82%) dhe sigurimi nga pasojat në rast fatkeqësie (aksidenti) merr pjesë me 6,56% (2018: 6,85%). Struktura sipas klasave më të rëndësishme të sigurimit, si dhe krahasimi me vitin 2018 është paraqitur në Grafikon nr. 4.

Grafiku nr. 2: Struktura e primit të shkruar bruto sipas klasave të sigurimit (përqindje)



Burimi: AMS

Zmadhim i PSHB-së prej 6,10% në raport me vitin 2018 është vërejtur në klasën e sigurimeve të përgjegjësive automobilistike (PA) me prim të përgjithshëm në shumë prej 4,58 miliarda denarësh (2018: 4,31 miliarda denarë) dhe zmadhim të numrit të marrëveshjeve të lidhura prej 5,36%, si dhe te sigurimi kasko të mjeteve motorike me prim të përgjithshëm në shumë prej 838,24 milionë denarësh (2018: 797,32 milionë denarë) dhe zmadhim të njëkohshëm prej 3,98% në numrin e marrëveshjeve të lidhura.

Te sigurimi i pronës vërehet zmadhim prej 3,12% me PSHB 1,77 miliarda denarë (2018: 1,72 miliarda denarë), gjatë zmadhimit të njëkohshëm prej 7,11% të numrit të marrëveshjeve të lidhura. Duke analizuar sipas grupeve, te personat fizikë kemi zmadhim prej 9,40% të marrëveshjeve të lidhura, i ndjekur me zmadhim prej 22,69% të PBP-së, kurse te personat juridikë kemi zmadhim të lehtë prej 0,17% të marrëveshjeve të lidhura, kurse zvogëlim prej 2,73% të PSHB-së.

Në suazat e sigurimit jetësor, te sigurimi bujqësor vërehet zmadhim prej 8,87% i numrit të marrëveshjeve të lidhura, si dhe zmadhim prej 48,12% i PSHB-së së realizuar për sigurim bujqësor i cili është 386,63 milionë denarë (2018: PBP prej 261,03 milionë denarësh).


Në vitin 2019, vërehet ngritje më e madhe në shitjen e sigurimeve shëndetësore me lidhje të 7.895 marrëveshjeve për sigurim shëndetësor me PBP të përgjithshme prej 188,88 milionë denarësh, që në krahasim me vitin 2018 përbën zmadhim prej 90,52% të numrit të marrëveshjeve të lidhura, përkatësisht 50,26% të PBP-së së përgjithshme.

Te sigurimi i jetës është realizuar PBP në shumë prej 1,83 miliarda denarësh (2018: 1,66 miliarda denarësh), që përfaqëson rritje prej 9,69%, ku sigurimi i jetës merr pjesë me 17,30% nga PSHB-ja e përgjithshme e sektorit të sigurimeve.

Te sigurimi tradicional i jetës (klasa 19) vazhdon trendi pozitiv i zmadhimit të PSHB-së në shumë prej 1,49 miliarda denarësh (2018: 1,39) që përbën rritje prej 6,78%, me zmadhim të numrit të marrëveshjeve të reja të lidhura për sigurim të jetës prej 38,20%, dhe kjo kryesisht me llojin e marrëveshjeve me termin për sigurim të jetës (rriziko). Te sigurimi i jetës kur rrezikun e investimit e merr përsimër i siguruari (klasa 21), po vazhdon trendi i theksuar i zmadhimit prej 35,99%, me PSHB të realizuar prej 226,54 milionë denarësh (2018: 166,59) dhe zmadhim të marrëveshjeve të lidhura prej 4,43%.

Në Grafikon nr. 5 është treguar trendi i PSHB-së sipas klasave të sigurimit.

Grafiku nr. 3: Trendi i primit të shkruar bruto sipas klasave të sigurimit (milionë denarë; boshti i djathtë – përqindjet)




Burimi: AMS

Gjatë vitit 2019 shoqëritë e sigurimeve kanë bërë 1.608.546 marrëveshje, ku është vërejtur zmadhim prej 8,95% në raport me vitin 2018 kur janë bërë 1.476.374 marrëveshje. Nga numri i përgjithshëm i marrëveshjeve të bëra, 1.578.629 polica janë në suazat e sigurimit jo-jetë, që përbën zmadhim prej 8,56% në krahasim me numrin e policave në vitin 2018 (2018: 1.454.110 polica), kurse 29.917 janë polica të sigurimit të jetës, përkatësisht zmadhim prej 34,37% në krahasim me vitin 2018. Ndryshimi i

numrit të marrëveshjeve të bëra sipas klasave më të rëndësishme të sigurimit është dhënë në Grafikon nr. 6.

Grafiku nr. 4: Marrëveshje të lidhura te shoqëritë e sigurimeve (numri; boshti i djathtë - përqindja)



Burim: AMB

3.1.5. Dëmet të paguara bruto

Shoqëritë e sigurimeve në vitin 2019 kanë paguar shuma bruto për dëme prej 4,03 miliarda denarësh (Tabela nr. 9). Në krahasim me vitin 2018, dëmet e paguara bruto shënojnë zmadhim prej 2,8% (2018: 3,92 miliarda denarë). Pjesëmarrja e risigurimit në dëmet e paguara bruto është 13,34%.

Tabela nr. 8: Dëme të paguara sipas klasave të sigurimit (mijë denarë)

Klasa të sigurimit	2019	Pjesëmarrja	2018	Pjesëmarrja	Dinamika 19/18
Autopërgjegjësia	2.060.176	51,11%	1.931.366	49,29%	6,67%
Sigurimi i mjeteve motorike (kasko)	542.704	13,46%	520.690	13,29%	4,23%
Sigurimi i pronës	483.427	11,99%	626.026	15,98%	-22,78%
Sigurimi nga aksidentet	421.000	10,44%	373.922	9,54%	12,59%
Sigurimi i jetës	347.218	8,61%	330.299	8,43%	5,12%
Sigurimi i ndihmës turistike	67.163	1,67%	59.828	1,53%	12,26%
Sigurime të tjera – jo-jetë	109.265	2,71%	76.375	1,95%	43,06%
Gjithsej	4.030.953	100,00%	3.918.506	100,00%	2,87%


Burimi: AMS

Në strukturën e dëmeve të paguara bruto, pjesëmarrje më të madhe kanë dëmet për autopërgjegjësi me 51,11%, pastaj vijojnë dëmet e paguara për sigurime kasko të mjeteve motorike me 13,46%, dëmet për sigurime të pronës me pjesëmarrje prej 11,99%, dëmet për sigurime nga aksidentet me 10,44% dhe 12,99% janë paguar dëme në klasat e tjera të sigurimit.

Në pjesën e sigurimit të pronës, vend të rëndësishëm merr sigurimi bujqësor me pjesëmarrje prej 41,89% dhe me dëme të përgjithshme të paguara prej 202,49 milionë denarësh.

Në Grafikon nr. 7 është treguar pjesëmarrja individuale e shoqërive të sigurimeve në shumë të dëmeve të paguara për vitin 2019.

Grafiku nr. 5: Pjesëmarrja e shoqërive të sigurimit në dëmet e paguara bruto në vitin 2019 (mijë denarë), veçmas për jo-jetë dhe jetë



Burimi: AMS

3.1.6. Mjetet dhe burimet e mjeteve

3.1.6.1. Struktura e mjeteve

Vlera e mjeteve të shoqërive të sigurimeve më 31.12.2019 është 23,95 miliardë denarë dhe është më e madhe për 20,53 % në raport me mjetet e përgjithshme të shoqëritë të sigurimeve në vitin 2018 (Tabela nr. 10).

Pjesëmarrje më të madhe prej 76,02% në strukturën e mjeteve të shoqërive të sigurimit kanë investimet (2018: 75,75%) dhe ato janë rritur me 10,93% në raport me mjetet e investuara në vitin 2018. Në kuadër të investimeve, pjesëmarrje më të rëndësishme prej 91,53% zë kategorinë e investimeve të tjera financiare dhe ajo ka rritje prej 13,23% në krahasim me vitin e kaluar. Në këtë kategori hyjnë: investimet financiare në dispozicion për shitje (47,15%), depozitat në banka, huatë dhe plasmanet e tjera (35,99%), investimet financiare të cilat ruhen deri në maturim (13,01%) dhe investimet financiare për tregtim

(3,85%). Kategoria tjetër më e rëndësishme janë investimet në truall, objekte ndërtimi dhe mjetet e tjera materiale (7,07%) të cilat shënojnë ulje prej 10,64% në raport me vitin 2018. Gjithashtu, një pjesë e investimeve janë investime financiare në shoqëri në grup - filiale, shoqëri të bashkuara dhe entitete të përbashkëta të bashkuara, që marrin pjesë me 1,40% në investimet e përgjithshme dhe ato shënojnë ulje prej 0,36%.

Tabela nr. 9: Struktura e mjeteve të shoqërive të sigurimeve (denarë)

	31.12.2019	Pjesëmarrja	31.12.2018	Pjesëmarrja	Dinamika 19/18
Mjete jomateriale	73.840.739	0,31%	63.336.480	0,29%	16,58%
Investime	18.181.249.466	76,02%	16.390.552.460	75,75%	10,93%
Pjesë për bashkësigurim dhe risigurim në rezervat bruto teknike	1.281.907.306	5,36%	1.148.962.057	5,31%	11,57%
Investimet financiare ku i siguruari e ndërmerr rrezikun investues (marrëveshje për sigurim)	239.766.212	1,00%	111.265.813	0,51%	115,49%
Mjete tatimore të prolonguara dhe aktuale	19.012.011	0,08%	14.658.653	0,07%	29,70%
Kërkesa	2.730.388.399	11,42%	2.621.668.762	12,12%	4,15%
Mjete të tjera	574.435.405	2,40%	560.808.211	2,59%	2,43%
Degëzime aktive të përkohshme	817.349.967	3,42%	727.512.871	3,36%	12,35%
Mjete joaktuale të cilat ruhen për shitje dhe aktivitetet joaktuale	0	0,00%	0	0,00%	0,00%
GJITHSEJ MJETE	23.917.949.505	100,00%	21.638.765.308	100,00%	10,53%

Burimi: AMS


Në vijim sipas rëndësisë, me pjesëmarrje prej 11,42% në strukturën e mjeteve, janë kërkesat dhe ato shënojnë rritje prej 4,15% në raport me kërkesat në vitin 2018 (2018: 12,12%). Në suazat e kërkesave futen edhe kërkesat për aktivitetet e drejtpërdrejta të sigurimeve (ku janë përfshirë kërkesat nga të siguruarit, kërkesa nga ndërmjetësuesit dhe kërkesa të tjera të aktiviteteteve të drejtpërdrejta në sigurim), kërkesa të veprimtarive në bashkësigurim dhe risigurim dhe kërkesa të tjera. Pjesëmarrje më të madhe prej 79,36% në kërkesat, kanë kërkesat për aktivitete të drejtpërdrejta të sigurimit në shumë prej 2,17 miliarda denarësh dhe shënojnë rritje prej 5,56% në raport me vitin 2018. Kërkesat e aktiviteteteve të bashkësigurimit dhe risigurimit kanë vlerë prej 81,16 milionësh denarë (2,97% të kërkesave të përgjithshme) dhe shënojnë zvogëlim prej 15,73% në krahasim me vitin 2018, si rezultat i zvogëlimit të kërkesave në bazë të pjesëmarrjes në kompensimin e dëmeve nga bashkësigurimi dhe risigurimi. Kërkesat e tjera kanë vlerë prej 482,48 milionë denarë (17,67% të kërkesave të përgjithshme) dhe ato janë rritur me 2,05% në raport me vitin 2018.

Edhe pse me pjesëmarrje prej 1,00% në strukturën e mjeteve, rritje më të madhe relative prej 115,49% vërehet te investimet financiare të cilat i siguruari e ndërmerr rrezikun investues. Shoqëritë për sigurimin e jetës të cilat punojnë në klasën 21 (Sigurim i jetës në rast kur rrezikun e investuimit e merr përsipër i siguruari) kanë obligim këto mjete, të cilat shërbejnë si mbulesë e rezervës së veçantë në

përputhje me nenin 94 të Ligjit për mbikëqyrje të sigurimeve, t'i investojnë në pjesët e fondeve të hapura investuese që janë regjistruar në Regjistrin e Fondeve Investuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse të cilin e udhëheq Komisioni i Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pjesa dominuese e mjeteve të përgjithshme në sektorin e sigurimeve i përbëjnë mjetet e shoqërive të sigurimit jo-jetë, megjithatë gjithnjë dhe më i pranishëm është trendi i zmadhimit të pjesëmarrjes së mjeteve të shoqërive të sigurimit të jetës, që në vitin 2019 është 38,20% (2018: 32,78%) të mjeteve të përgjithshme të shoqërive të sigurimeve. Struktura e pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimeve në mjetet e përgjithshme të sektorit të sigurimeve është dhënë në Grafikon nr. 8.

Grafiku nr. 6: Struktura e pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimeve në mjetet e përgjithshme të sektorit të sigurimeve në vitin 2018 (milionë denarë), veçmas për jetë dhe jo-jetë



Burimi: AMS

3.1.6.2. Struktura e burimeve të mjeteve

Burimet e mjeteve të shoqërive të sigurimeve në vitin 2019 shënon rritje prej 10,53% në raport me vitin 2018 (Tabela nr. 11).

Pjesëmarrje më të madhe prej 59,74% në strukturën e burimeve të shoqërive të sigurimeve kanë rezervat teknike bruto (2018: 58,95%) dhe ato kanë një rritje prej 12,03% në raport me vitin e kaluar.

Kategoria tjetër, me pjesëmarrje prej 29,77% në strukturën e burimeve të mjeteve, janë kapitali dhe rezervat të cilat janë rritur me 4,99%.

Obligimet e shoqërive të sigurimeve, të cilat në strukturën e burimeve marrin pjesë me 7,30% (2018: 7,43%) shënojnë rritje prej 13,04% në raport me vitin e mëparshëm. Në strukturën e obligimeve, pjesëmarrje më të madhe kanë obligimet e tjera (50,23%), obligimet nga aktivitetet me risigurimin dhe bashkësigurimin dhe obligimet e veprimtarive të drejtpërdrejta të sigurimit (6,06%).

Tabela nr. 10: Struktura e burimeve të mjeteve të shoqërive të sigurimeve (denarë)

	31.12.2019	Pjesëmarrja	31.12.2018	Pjesëmarrja	Dinamika 19/18
Kapitali dhe rezervat	7.120.891.599	29,77%	6.782.542.488	31,34%	4,99%
Obligimet subordinare	156.790.030	0,66%	109.563.920	0,51%	43,10%
Rezervat teknike bruto	14.289.238.412	59,74%	12.755.357.559	58,95%	12,03%
Rezervat teknike bruto në raport me marrëveshjet të të cilat i siguruari e ndërmerr rrezikun investues	239.766.212	1,00%	111.264.162	0,51%	115,49%
Rezerva të tjera	73.462.578	0,31%	49.631.672	0,23%	48,02%
Obligime tatimore të prolonguara dhe vijuese	34.643.998	0,14%	33.711.893	0,16%	2,76%
Obligime që dalin nga depoziatat e shoqërive të sigurimeve për risigurim të cedentëve, në bazë të risigurimit	66.660.261	0,28%	47.520.705	0,22%	40,28%
Obligime	1.745.161.079	7,30%	1.543.786.951	7,13%	13,04%
Degëzime pasive të përkohshme	191.335.335	0,80%	205.385.958	0,95%	-6,84%
GJITHSEJ BURIME TË MJETEVE	23.917.949.505	100,00%	21.638.765.308	100,00%	10,53%

Burimi: AMS

3.1.7. Provigjone teknike

Shuma e përgjithshme e provigjoneve teknike të shoqërive të sigurimeve që kryejnë punë të sigurimit jo-jetë në fund të vitit 2019 është 8,24 miliarda denarë, përkatësisht 8,20% zmadhim në krahasim me vitin e mëparshëm, kurse, përsëri, shuma e përgjithshme e provigjoneve teknike të shoqërive të sigurimit që kryejnë punë të sigurimit në grupin e sigurimit të jetës është 6,28 miliarda denarë, që përbën zmadhim prej 19,77% në raport me vitin e kaluar.

Tabela nr. 11: Struktura dhe ndryshimi i provigjoneve teknike (mijë denarë)

Struktura e provigjoneve teknike	Jojetë			Jetë			Gjithsej		
	2019	2018	19/18	2019	2018	19/18	2019	2018	19/18
Provigjone për dëmet	4.124.483	3.800.347	8,53%	92.033	85.447	7,71%	4.216.516	3.885.794	8,51%
Provigjone për primet e transferueshme	4.009.126	3.736.679	7,29%	35.973	34.437	4,46%	4.045.099	3.771.116	7,27%
Provigjone matematikore	0	0	0,00%	6.035.373	5.009.587	20,48%	6.035.373	5.009.587	20,48%
Provigjone për bonuse dhe lirime	87.223	64.733	34,74%	120.186	116.952	2,77%	207.409	181.685	14,16%
Provigjone të tjera teknike	24.595	18.447	33,33%	0	0	0,00%	24.595	18.447	33,33%
Gjithsej	8.245.427	7.620.206	8,20%	6.283.565	5.246.423	19,77%	14.528.992	12.866.629	12,92%

Burimi: AMS


Në strukturën e provigjoneve teknike pjesëmarrje më të madhe kanë provigjonet për dëmet dhe provigjonet për primet e transferueshme, kurse te shoqëritë e sigurimeve që kryejnë aktivitete të sigurimeve në grupin e jetës, pas këtyre kategorive vendin më të rëndësishëm e zë provigjoni matematikor (Tabela nr. 12).

3.1.8. Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike

Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike janë ato mjete të shoqërisë së sigurimeve që shërbejnë për mbulim të obligimeve të ardhshme që dalin nga marrëveshjet e sigurimeve, si dhe për mbulimin e humbjeve të mundshme në raport me ato rreziqe që lidhen me kryerjen e punëve të sigurimeve, për të cilat shoqëria e sigurimeve është e obliguar të veçojë mjete për mbulim të provigjoneve teknike neto. Shoqëria e sigurimeve është e obliguar të investojë mjete në madhësi, të paktën, të barabartë me vlerën e provigjoneve teknike, neto të risigurimit, në përputhje me dispozitatat e Ligjit të mbikëqyrjes të sigurimit dhe në përputhje me Rregulloren e llojeve dhe karakteristikave të mjeteve të cilat i mbulojnë mjetet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjonet matematikore, si dhe plasimin e detajuar dhe kufizimin e atyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/11, 127/14, 61/16 dhe 36/19).

Investimet e mjeteve që i mbulojnë provigjonet teknike të shoqëritë për sigurime jo-jetë, në fund të vitit 2019 kapin vlerë prej 8,29 miliarda denarësh dhe mbulonin 117,29% (2018: 110,76%) të rezervave të përgjithshme neto teknike (Grafiku nr. 9 **Error! Reference source not found.**).

Grafiku nr. 7: Mbulimi i rezervave neto teknike të shoqëritë e sigurimit jo-jetë (milionë denarë; boshti i djathtë - përqindje)



Burimi: AMS

Mjetet të cilat i mbulojnë provigjone teknike të shoqëritë e sigurimit jo-jetë janë plasuar në letra me vlerë të lëshuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut (47,94%), depozita në banka (40,32%), pjesëmarrje në fonde investuese (9,17%) dhe aksione (2,57%). Shumat dhe struktura e investimeve janë dhënë në Tabelën nr. 13.


Tabela nr. 12: Mjetet që i mbulojnë provigjonet teknike të shoqëritë e sigurimit jo-jetë (mijë denarë)

	2019	2018	2017
Llogari bankare dhe depozita në banka	3.345.592	3.258.311	2.886.140
Letra me vlerë shtetërore	3.977.336	3.370.466	3.364.546
Aksione	213.021	120.472	101.919
LV afatgjata të lëshuara nga BE-ja ose OECD-ja	0	36.407	74.795
Fonde investuese	760.648	474.738	391.001
Gjithsej	8.296.596	7.260.394	6.818.401

Burimi: AMS

Te shoqëritë që punojnë sigurime jete, investimet e mjeteve nga provigjonet teknike dhe provigjonet matematikore kapin vlerën prej 6,10 miliarda denarësh dhe kanë mbulim të provigjoneve neto teknike prej 102,87% (2018: 104,08%) (Grafiku nr. 8).

Grafiku nr. 8: Mbulimi i provigjoneve neto teknike te shoqëritë për sigurim të jetës (milionë denarë; boshti djathtas - përqindje)



Burimi: AMS

Shoqëritë e sigurimeve të jetës pjesën më të madhe të mjeteve që e mbulojnë provigjonin matematikor investojnë në letra shtetërore me vlerë të nxjerra nga Republika e Maqedonisë së Veriut (74,77%), depozita në banka (23,84%) fonde investuese (0,64%) dhe në instrumente të tjera financiare (0,75%) (Tabela nr. 14).

Tabela nr. 13: Mjetet që i mbulojnë provigjonet teknike që i mbulojnë rezervat teknike dhe provigjonet matematikore te shoqëritë e sigurimeve të jetës (mijë denarë)

	2019	2018	2017
Llogari bankare dhe depozita në banka	1.454.971	1.106.998	922.944
Letra me vlerë shtetërore	4.562.433	4.052.740	3.354.867
Aksione	0	0	0
LV afatgjata të lëshuara nga BE-ja ose OECD-ja	0	0	0
Fonde investuese	38.941	58.879	23.520
Tjetër	45.512	38.272	31.287
Gjithsej	6.101.857	5.256.889	4.332.618

Burimi: AMS

3.1.9. Adekuatshmëria e kapitalit të shoqërive të sigurimeve


Në përputhje me nenet 75 dhe 76 të Ligjit për mbikëqyrje të sigurimeve, shoqëritë e sigurimeve duhet ta ruajnë vlerën e kapitalit në madhësinë e nivel të nevojshëm të margjinës së solvencës. Sipas të dhënave të dorëzuara në AMS, në fund të vitit 2019, kapitali i llogaritur i përgjithshëm i shoqërive të sigurimeve⁵ kap vlerën prej 6,65 miliarda denarësh, që përbën rritje prej 5,22% në raport me vitin 2018. Duke e

⁵ Rregullorja e llojeve dhe përshkrimit të paragrafëve që do të merren parasysh gjatë llogaritjeve të kapitalit të shoqërisë së sigurimeve dhe/ose risigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/11, 64/11, 61/16 dhe 170/19")

analizuar sipas grupeve të sigurimit, kapitali i shoqërive të sigurimit jo-jetë është 5,18 miliarda denarë, kurse e shoqërive të sigurimit të jetës 1,46 miliarda denarë.

Margjina e solvencës, si indikator kryesor i vlerësimit të stabilitetit të sektorit të sigurimeve, është 1,69 miliarda denarë (te sigurimi jo-jetë 1,30 miliarda denarë, kurse te sigurimi i jetës 391 milionë denarë), kështu që kapitali i sektorit të sigurimit është 3,9 herë mbi nivelin e margjinës së solvencës. Lëvizja e kapitalit dhe margjina e nevojshme e solvencës te shoqëritë e sigurimeve jepet në Grafikon nr. 11 .

Grafiku nr. 9: Lëvizja e kapitalit dhe margjina e solvencës te shoqëritë e sigurimeve (milionë denarë)



Burimi: AMS

3.1.10. Rezultati financiar nga kryerja e aktiviteteve

Gjatë vitit 2019, sektori i sigurimeve realizoi humbje në shumë prej 25,37 milionë denarësh, përkundrejt fitimit të realizuar në shumë prej 352,68 milionë denarësh në vitin 2018 (Grafiku nr. 12).

Shoqëritë për sigurim jo-jetë realizuan humbje prej 125,91 milionë denarësh (2018: fitim prej 269,65 milionë denarësh) që del nga rezultati i shtatë shoqërish që realizuan fitim në shumë prej 308,03 milionë denarësh dhe katër shoqëri që realizuan humbje në shumë prej 433,94 milionë denarësh.

Me rëndësi të veçantë është analiza e humbjeve në shumë prej 338,55 milionë denarësh, përkatësisht 78,02% nga humbja e përgjithshme, që del nga dy shoqëritë të cilat ndodhën ndërmarrjet (Hall Osiguruvanje SHA Shkup dhe Grave Osiguruvanje Jojetë SHA Shkup)⁶. Këto shoqëri para ndërmarrjes ishin në masa intensive supervizore prej të cilave më relevantet për këtë çështje janë nënvlerësuar provigjonet teknike dhe janë mbivlerësuar investimet në patundshmëri. Me ndërmarrjen, pronarët e rinj ndërmorën masa për harmonizim me masat e shqiptuara nga supervizioni me qëllim që të zmadhohen provigjonet teknike dhe të harmonizohen vlerat e patundshmërive⁷ në përputhje me rregullat e ndryshuara.


⁶ Detaje për ndërmarrjen janë dhënë në kapitullin 3.1 Shoqëri të sigurimeve (f. 8 dhe 9)

⁷ Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për plan konten të shoqërive të sigurimeve dhe risigurimeve, miratuar nga Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve, në mbledhjen e mbajtur më 07.08.2019, shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.170/2019, dhe Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare dhe përmbajtjes së detajuar të raportit vjetor të punës së shoqërive të sigurimeve dhe/ose risigurimeve, miratuar nga Këshilli i

Me zbatimin e kujdesshëm të rregullave këto shoqëri sigurimi u ballafaquan me humbje, por përfunduan njëkohësisht dhe rikapitalizimin, duke e përforcuar kështu pozitën kapitale të shkaktuar nga humbja e ndodhur. Nga kjo mund të nxirret përfundimi se bëhet fjalë për ngjarje të njëfishta me efekt përfundimtar të përmirësimit të stabilitetit financiar në sektorin e sigurimeve. Humbjet e ndodhura janë plotësuar me kapital, kështu që pronarët e rinj dëshmuar interesim serioz që të posedojnë shoqëri të shëndetshme për sigurimet.

Shoqëritë e sigurimeve të jetës realizuan fitim prej 100,54 milionë denarësh (2018: fitim prej 83,02 milionë denarësh) që del si rezultat i tri shoqërive që realizuan fitim prej 123,25 milionë denarësh dhe dy shoqëri që realizuan humbje në shumë prej 22,71 milionë denarësh.

Grafiku nr. 10: Rezultati financiar nga puna e shoqërive të sigurimeve në (milionë denarë)



Burime: AMS

3.1.11. Indikatorë të sektorit të sigurimeve

Treguesit në veprimtarinë e sigurimeve përdoren për ndjekje më të mirë të punës së shoqërive të sigurimit.

Koeficienti i dëmeve llogaritet si raport midis dëmeve të ndodhura në këtë periudhë dhe primit, **kurse koeficienti i shpenzimeve** përfaqëson raportin midis shpenzimeve për zbatimin e sigurimit dhe primit. Shuma e këtyre dy koeficienteve e jep **koeficientin e kombinuar**. Më detajisht, sipas grupeve të sigurimit në tabelën nr. 15 janë dhënë koeficientet me bazë bruto dhe bazë neto, përkatësisht pas izolimit të efektit të risigurimit.

Tabela nr. 14: Koeficientet teknike

	2019			2018		
	Koeficient i dëmit	Koeficient i shpenzimeve	Koeficient i kombinuar	Koeficient i dëmit	Koeficient i shpenzimeve	Koeficient i kombinuar
Neto koeficient						
Jo-jetë	52,50%	51,46%	103,96%	49,40%	50,10%	99,50%
Jetë	76,66%	32,72%	109,38%	75,90%	30,90%	106,70%

Ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve, në mbledhjen e mbajtur më 07.08.2019, shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 170/2019.

Gjithsej	57,63%	47,48%	105,11%	54,80%	46,10%	101,00%
Bruto koeficient						
Jo-jetë	47,94%	45,44%	93,38%	45,90%	45,00%	90,90%
Jetë	75,60%	32,47%	108,07%	74,70%	31,00%	105,70%
Gjithsej	52,94%	43,09%	96,03%	51,00%	42,50%	93,50%

Burimi: AMS

Norma e kthimit të investimeve (ROI) llogaritet si raport i të hyrave të zvogëluara me shpenzimet e investimeve dhe shumën e investimeve. Norma e kthimit të investimeve në nivel të industrisë për vitin 2019 është 2,46%, që flet se trendi i zvogëlimit të kthimit të investimeve vazhdon (2018: 3,09%). Individualisht, sipas grupeve të sigurimit, vërejmë se norma e kthimit të investimeve të sigurimi jo-jetë në vitin 2019 është 1,42%, përkundrajt 2,76% të realizuara në vitin 2018, kurse të sigurimi jetë në vitin 2019 kjo normë është 4,00% që përbën rritje në raport me vitin e mëparshëm kur ka qenë 3,63%.

Norma e kthimit nga aktivet (ROA) llogaritet si raport i fitimit neto dhe mjeteve të përgjithshme. Në nivel të industrisë ky indikator është -0,11% që nënkupton zvogëlim në raport me vitin e kaluar kur ka qenë 1,69%. Individualisht, sipas grupeve të sigurimit, norma e kthimit nga aktivet të sigurimi jo-jetë në vitin 2019 është -0,08%, përkundrajt 1,8% në vitin 2018, kurse të sigurimi i jetës në vitin 2019 është 1,22% në raport me vitin e mëparshëm kur ka qenë 1,17%.

Norma e kthimit nga kapitali (ROE) llogaritet si raport i fitimit neto dhe kategorisë kapital dhe rezerva. Në nivel të industrisë ky indikator është -0,36% përkundrajt 5,29% në vitin 2018. Individualisht, sipas grupeve, norma e kthimit të kapitalit të sigurimi jo-jetë në vitin 2019 është -2,28% që përfaqëson zvogëlim në raport me vitin e kaluar kur ka qenë 5,1%, kurse të sigurimi i jetës në vitin 2019 është 6,29% që flet për rritje në krahasim me vitin 2018 kur ka qenë 5,5%.

Koeficienti i borxhit llogaritet si raport i obligimeve të përgjithshme dhe mjeteve të përgjithshme. Ky koeficient dëshmon sa prej mjeteve janë financuar nga obligimet (rezervat teknike dhe obligimet e tjera) pa u përfshirë kapitali dhe rezervat ligjore. Në vitin 2019 ky koeficient ka qenë 70,2%, për përbën zmadhim në raport me vitin 2018 kur ka qenë 68,7%.

Pasqyrë e të gjithë këtyre indikatorëve financiarë është dhënë në Tabelën nr. 16.

Tabela nr. 15: Indikatorë financiarë

	2019				2018			
	ROI	ROA	ROE	Borxhi	ROI	ROA	ROE	Borxhi
Jo-jetë	1,42%	-0,80%	-2,28%	64,72%	3,09%	1,89%	5,19%	63,78%
Jetë	4,00%	1,22%	6,29%	80,66%	3,63%	1,26%	5,63%	78,64%
Gjithsej	2,46%	-0,11%	-0,36%	70,23%	3,31%	1,69%	5,29%	68,66%

Burimi: AMS

3.2. NDËRMJETËSIMI NË SIGURIME

Roli i ndërmjetësimit në shitje ka ndikim gjithnjë dhe më të madh në sektorin e sigurimeve. Gjatë vitit 2019 46,61% (2018: 48,74%) e PSHB-së së realizuar është realizuar nëpërmjet shitjes së drejtpërdrejtë nga shoqëritë e sigurimeve, kurse 53,39% (2018: 51,26%) janë realizuar nga kanalet indirekte të ndërmjetësimit (Tabela nr. 17).

Tabela nr. 16: Struktura e kanaleve të shitjes së polisave sipas PSHB-së të realizuar (mijë denarë)

	2019	%	2018	%	2017	%
Shitja e drejtpërdrejtë	4.933.179	46,61%	4.838.893	48,74%	4.551.392	50,62%
Shoqëritë e brokerimit në sigurime	3.135.577	29,63%	2.745.963	27,66%	2.380.037	26,47%
Përfaqësuesit në sigurime	1.046.595	9,89%	1.053.116	10,61%	991.211	11,02%
Shoqëritë për përfaqësim në sigurim	898.496	8,49%	858.660	8,65%	829.413	9,22%
Bankat	508.507	4,80%	371.757	3,74%	193.260	2,15%
Agjencitë turistike	32.593	0,31%	34.198	0,34%	34.674	0,39%
Kanalet e tjera të shpërndarjes	17.823	0,17%	15.937	0,16%	5.019	0,06%
Sallon automobilash	10.633	0,10%	9.041	0,09%	7.071	0,08%
Gjithsej	10.583.403	100,00%	9.927.565	100,00%	8.992.077	100,00%

Burimi: AMS

3.2.1. Përfaqësimi në sigurime

Përfaqësimi në sigurime paraqet përgatitje dhe lidhje të marrëveshjeve për sigurim, në emër dhe për llogari të një apo më shumë shoqërive të sigurimeve, për prodhimet e sigurimit të cilat nuk janë konkurrencë midis tyre. Përfaqësimi në tregun e sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryhet nëpërmjet përfaqësuesve në sigurime – persona fizikë, shoqëri për përfaqësim në sigurime dhe banka të cilat kanë marrë leje për kryerjen e punëve për përfaqësim në sigurime. Nëpërmjet këtyre kanaleve, në vitin 2019 janë realizuar 23,8% të PBP-së (2018: 23,6%), përkatësisht 2,51 miliarda denarë (2018: 2,34 miliarda denarë) që përfaqëson rritje prej 7,34% në raport të vitit të kaluar.

Përfaqësimi në sigurime nëpërmjet personave fizikë, kryhet në bazë të licencës së AMS-së që e kanë marrë pas dhënies paraprake të provimit për ushtrimin e punëve për përfaqësim në sigurim. Në PSHB-në e përgjithshme përfaqësimi në sigurime nëpërmjet personave fizikë merr pjesë me 9,9%, kështu që në vitin 2019 numri i përfaqësuesve të cilët kanë licencë nga AMS-ja është 1.508. Regjistri i të gjithë përfaqësuesve aktivë në sigurime gjendet në faqen e internetit të AMS-së⁸.

Numri i shoqatave për përfaqësim në sigurim në vitin 2018 u zvogëlua me dy shoqëri për përfaqësim në sigurim (Vendimi për përfundim të lejes për kryerje të punëve të përfaqësimit në sigurim të MAKO AC dhe të L.I.F.E.), kurse i është dhënë leje për ushtrimin e aktivitetit një shoqërie të re për përfaqësim në sigurime (DZO SIGURIMI IM), përkatësisht gjatë vitit 2019 në tregun e sigurimeve veprojnë aktivisht dhjetë shoqëri për përfaqësim (Tabela nr. 18). Në PSHB-në e përgjithshme shoqëritë për përfaqësim në sigurime në vitin 2019 kanë marrë pjesë me 898,49 milionë denarë ose 8,49% nga ndërmjetësimi i përgjithshëm (2018: 8,65%), por edhe pse ka zvogëlim të pjesëmarrjes relative, vërehet rritje prej 4,64% në raport me vitin e kaluar (2018: 858,66 milionë denarë).

⁸http://aso.mk/wp-content/uploads/2019/12/registar_licenczirani-zastapniczi-vo-osiguruvanje-12-2019.pdf

Gjithashtu, përfaqësimi në sigurime mund të kryejë edhe banka e cila ka marrë leje për ushtrimin e punëve të përfaqësimit në sigurime nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa me pëlqim paraprak nga AMS-ja. Në vitin 2019 u është dhënë pëlqim për kryerjen e aktiviteteve të përfaqësimit 3 bankave (Komerçijalna banka SHA Shkup, Uni Banka SHA Shkup dhe TTK banka SHA Shkup) dhe një Vendim për tërheqje të pëlqimit për kryerjen e punëve të përfaqësimit për Ohridska banka SHA Shkup, kështu numri i bankave në raport me vitin e kaluar është zmadhuar me dy banka, përkatësisht në fund të vitit 2019, në domenin e bankave të cilat kanë leje për kryerjen e punëve të përfaqësimit në sigurime, funksionojnë 7 banka, (2018: 5) dhe marrin pjesë me 508,50 milionë denarë ose 4,80% në PSHB-në e përgjithshme, që përfaqëson rritje enorme prej 36,78% në raport me vitin e kaluar (2018: 371,75 milionë denarë).

Tabela nr. 17: Regjistri i shoqërive të përfaqësimit në sigurime dhe banka


Emërtimi i shoqërisë	
1	Shoqëri për përfaqësim në sigurime AKTIVA OSIGURUVANJE SHA Shkup
2	Shoqëri për përfaqësim në sigurime TREND-MR SHA Shkup
3	Shoqëri aksionare për përfaqësim në sigurime LAJON INS SHA Shkup
4	Shoqëri për përfaqësim në sigurime REA INSHURENS GRUP SHA Shkup
5	Shoqëri aksionare për përfaqësim në sigurime SAFE LIFE Maqedonia SHA Shkup
6	Shoqëri për përfaqësim në sigurime FORTIS SHA Shkup
7	Shoqëri për përfaqësim në sigurime LAJF VIZION SHA Shkup
8	Shoqëri për përfaqësim në sigurime MIKU JUAJ (VASH PRIJATEL) SHA Prilep
9	Shoqëri aksionare për përfaqësim në sigurime FEMILI PARTNER SHA Shkup
10	Shoqëri aksionare për përfaqësim në sigurime SIGURIMI IM (MOE OSIGURUVANJE) SHA Shkup
11	Shparkase banka SHA Shkup
12	NLB Tutunska banka SHA Shkup
13	HALK banka SHA Shkup
14	Stopanska banka SHA Shkup
15	Komerçijalna banka SHA Shkup
16	UNI banka SHA Shkup
17	TTK banka SHA Shkup

Burimi: AMS

Gjatë vitit 2019 nëpërmjet shoqërive të përfaqësimit në sigurime janë bërë 87.826 marrëveshje për sigurim (polica) (2018: 87.730), që përfaqëson zvogëlim prej 0,11% në raport të vitit të mëparshëm. Nëpërmjet bankave, në vitin 2019 janë bërë 138.278 marrëveshje për sigurime (2018: 81.288), që përbën rritje prej 70, 11% në raport me vitin e kaluar.

Shpërndarja e PSHB-së së përgjithshme, sipas klasave të sigurimit, kurse është realizuar nga shoqëritë për përfaqësim dhe bankat është paraqitur në Grafikon nr. 13.

Grafiku nr. 11: Struktura e PSHB-së, sipas klasave të sigurimeve



Burimi: AMS

3.2.1. Veprimtari brokerimi në sigurime

Veprimtaritë e brokerimit në sigurime nënkuptojnë ndërmjetësim në dakordimin e mbulimit të sigurimit dhe risigrimit, si dhe gjatë realizimit të kërkesave të dëmshpërblimit pas ndodhjes së ngjarjes dëmtuese të siguruar te shoqëritë e sigurimeve dhe risigurimeve, në emër dhe në llogari të klientëve. Nëpërmjet këtij kanali të shpërndarjes, shoqëritë për veprimtari brokerimi në sigurime në vitin 2019 kanë realizuar 29,63% të PSHB-së (2018: 27,66%), përkatësisht 3,13 miliardë denarë (2018: 2,74 miliardë denarë) që përbën rritje prej 14,19% në raport me vitin e kaluar.

Në fund të vitit 2019 në tregun e sigurimeve kanë vepruar 39 shoqëri brokerimi në sigurime (2018: 37), (Tabela nr. 19). Gjatë vitit 2019 është dhënë leje për ushtrimin e aktivitetit të katër shoqërive të reja të brokerimit në sigurime (Shoqëria e brokerimit në sigurimit MAKOAS BROKER SHA Strumicë, Shoqëria e brokerimit në sigurime SMART MANI SOLLUSHNS SHA Shkup, Shoqëria e brokerimit në sigurime IBIS OSIGURUVANJE SHA Strumicë, Shoqëria e brokerimit në sigurime ALFA BROKER SHA Kumanovë), dhe deri në fund të vitit 2019 të gjithë kanë filluar me kryerjen e veprimtarive të brokerimit në sigurime, kurse është marrë leja për ushtrim të Shoqërisë të brokerimit në sigurime K MK BROKER SHA Shkup, dhe është nxjerrë vendim për përfundim të lejes për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve për Shoqërinë e brokerimit në sigurime ENSA BROKER SHA Shkup.

Tabela nr. 18: Regjistër i shoqërive të brokerimit në sigurime

Emërtimi i shoqërisë	
1	Shoqëri aksionare e brokerimit në sigurime EUROEKSPERTS Shkup
2	Shoqëri e brokerimit në sigurime EUROMAK BROKER SHA Shkup
3	Shoqëri e brokerimit në sigurime IN BROKER SHA Shkup
4	Shoqëri aksionare e brokerimit në sigurime BFP SHA Shkup
5	Shoqëri e brokerimit në sigurime MOBILITI BROKER SHA Shkup
6	Shoqëri e brokerimit në sigurime SEDA BROKER SHA Shkup
7	Shoqëri e brokerimit në sigurime SIGURIMI YNË (NASHE OSIGURUVANJE) SHA Koçani
8	Shoqëri e brokerimit në sigurime JDB BROKER SHA Shkup
9	Shoqëri e brokerimit në sigurime DELTA INS BROKER SHA Shkup
10	Shoqëri e brokerimit në sigurime A-TIM Shkup
11	Shoqëri e brokerimit në sigurime LEGRA SHA Shkup
12	Shoqëri e brokerimit në sigurime POLISA PLUS SHA Shkup


13	Shoqëri e brokerimit në sigurime AMG PREMIUM SHA Shkup
14	Shoqëri e brokerimit në sigurime SUPER BROKER SHA Shkup
15	Shoqëri e brokerimit në sigurime KORAB INS SHA Shkup
16	Shoqëri e brokerimit në sigurime NOV OSIGURITELEN BROKER SHA Shkup
17	Shoqëri e brokerimit në sigurime CERTUS SHA Shkup
18	Shoqëri e brokerimit në sigurime STM Broker Plus SHA Shkup
19	Shoqëri e brokerimit në sigurime AM Broker SHA Shkup
20	Shoqëri e brokerimit në sigurime MEGA BROKER SHA Shkup
21	Shoqëri e brokerimit në sigurime CVO Broker SHA Shkup
22	Shoqëri e brokerimit në sigurime ASUC Broker SHA Shkup
23	Shoqëri e brokerimit në sigurime SAFE INVEST SHA Shkup
24	Shoqëri e brokerimit në sigurime VIA BROKER SHA Gllumovë Shkup
25	Shoqëri e brokerimit në sigurime VEBER GMA SHA Manastir
26	Shoqëri e brokerimit në sigurime MAK TREND BROKER SHA Shkup
27	Shoqëri e brokerimit në sigurime SN OSIGURITELEN BROKER SHA Manastir
28	Shoqëri aksionare për kryerjen e veprimtarive të brokerimit në sigurime PORSHE BROKER Shkup
29	Shoqëri e brokerimit në sigurime XHOKER INS BROKER SHA Gjevgjeli
30	Shoqëri e brokerimit në sigurime EOS BROKER SHA Shkup
31	Shoqëri e brokerimit në sigurime PETROLL – OIL BROKER SHA Shkup
32	Shoqëri e brokerimit në sigurime AURON BROKER SHA Strugë
33	Shoqëri e brokerimit në sigurime RRIZIKO OSIGURUVANJE SHA Shkup
34	Shoqëri e brokerimit në sigurime VIN BROKER SHA Shkup
35	Shoqëri e brokerimit në sigurime BROLINS SHA Shkup
36	Shoqëri e brokerimit në sigurime MAKOAS BROKER SHA Strumicë
37	Shoqëri e brokerimit në sigurime SMART MANI SOLLUSHNS SHA Shkup
38	Shoqëri e brokerimit në sigurime IBIS OSIGURUVANJE SHA Strumicë
39	Shoqëri e brokerimit në sigurime ALFA BROKER SHA Kumanovë

Burimi: AMS

Në këtë periudhë shoqëritë e brokerimit në sigurime kanë realizuar shitje të 335.253 policave (2018: 302.690), që përbën rritje prej 8,2% në raport me vitin e kaluar.

Shpërndarja e PSHB-së së përgjithshme, sipas klasave të sigurimit, që është realizuar nga shoqëritë e brokerimit në sigurime, është dhënë në Grafikon nr. 14.

Grafiku nr. 12: Struktura e PSHB-së, sipas klasave të sigurimit



Burimi: AMS

3.3. BYROJA NACIONALE E SIGURIMIT

Në përputhje me Ligjin për sigurim të obliguar në transport, Byroja Nacionale e Sigurimit (në tekstin e mëposhtëm. "BNS") i kryen aktivitetet e parapara me marrëveshjet ndërkombëtare për sigurim të pronarëve dhe përdoruesve të mjeteve motorike, nga përgjegjësia në qarkullim (kartoni i gjelbër) dhe i përfaqëson shoqëritë e sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të sigurimeve. BNS-ja, jep dhe shtyp karta të gjelbra ndërkombëtare për nevojat e anëtarëve, mban evidencën statistikore dhe kryen përpunim statistikor të të dhënave statistikore të shoqërive të sigurimeve, vendos dhe mban sistem qendror mbi evidencën e policave dhe dëmeve nga përdorimi i mjeteve motorike.

BNS-ja është anëtare e Këshilli të Byrove në Bruksel që nga viti 1994, i cili ka për qëllim të lehtësojë qarkullimin rrugor ndërkombëtar të mjeteve motorike dhe shoqëruese, nëpërmjet sigurimit nga përgjegjësia për dëme të shkaktuara nga persona të tretë, sipas kushteve të cilat janë përcaktuar në vendin e vizituar dhe garanton se personave të dëmtuar në rast të fatkeqësisë rrugore do t'u kompensohet dëmi i shkaktuar me përdorim të mjetit motorik, me zbatim të legjislacionit nacional të atij vendi. Njëkohësisht, si anëtare e Këshillit, BNS-ja merr pjesë në punën e Grupit Evropian Juglindor ku marrin pjesë vendet nga rajoni.

Në BNS janë anëtare njëmbëdhjetë shoqëri sigurimesh, përkatësisht të gjitha shoqëritë për sigurim jo-jetë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në raportin për punën të cilin BNS-ja e dorëzoi në AMS, në përputhje me nenin 54 paragrafi (3) i Ligjit për sigurim të obliguar në transport, është pasqyruar puna financiare e BNS-së dhe puna financiare e Fondit Garantues për vitin 2019.

Gjendja më 31.12.2019, mjetet e përgjithshme të BNS-së është 316,4 milionë denarë, prej të cilave 194,3 milionë se mjetet aktuale, kurse 122,1 milionë të tjerat lidhen me mjetet joaktuale dhe në krahasim me vitin e kaluar shënojnë zmadhim prej 4,6%. Në mjetet e përgjithshme të BNS-së, pjesëmarrje më të madhe prej 55,62% zënë depozitat në banka, pastaj vijnë kërkesat e shoqërive të sigurimeve me 36,09% dhe investimet në letrat me vlerë me 3,37%. Në obligimet dhe kapitalin e përgjithshëm të BNS-së në vitin 2019, kapitali ka marrë pjesë me 60,40%, kurse obligimet me 39,43%. Në vitin 2019 BNS-ja ka realizuar fitim në shumë prej 1.282 mijë denarë (viti 2018: fitim prej 2.701 mijë denarë).

3.3.1. Fondi garantues i BNS-së

BNS-ja, në përputhje me nenin 58 të Ligjit për sigurim të obligueshëm në transport, formon Fond Garantues i cili shërben për pagim të:

1. dëmeve të shkaktuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjete motorike dhe shoqëruese të panjohura dhe të pasiguruara, varka dhe anije me fuqi motorike të pasiguruara, si dhe mjete të pasiguruara të aviacionit;
2. dëmeve të shkaktuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjete të transportit të regjistruara për transport të udhëtarëve në qarkullimin publik, për të cilat

pronarët nuk kanë bërë marrëveshje sigurimi të udhëtarëve nga pasojat e rastit aksidental - aksident;

3. dëmeve nga sigurimet e obligueshme për të cilat personat e dëmtuar nuk mund t'i marrin pagesat për shkak të përfundimit me punë të shoqërisë së sigurimeve me të cilën është bërë marrëveshje për sigurim, ku paguhet vetëm ajo pjesë e dëmit i cili nuk është kompensuar pasuria e falimentimit të shoqërisë së sigurimeve; dhe
4. dëmeve nga mjetet motorike të siguruara të cilat kanë prejardhje nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të cilat në përputhje me Marrëveshjen e Kretës dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare i garanton Byroja Nacionale e Sigurimit.

Puna e Fondit Garantues bazohet në Ligjin për sigurim të obligueshëm në transport, si dhe Rregulloren për formim dhe përdorim të Fondit Garantues dhe Udhëzimit për mbajtjen e evidencës dhe mënyrën e pagesës së mjeteve nga Fondi Garantues, të miratuar nga MBS-ja.

Tabela nr. 19: Pjesëmarrja në Fondin Garantues sipas shoqërive të sigurimit për periudhën 01.01.-31.12.2019 (denarë)

Emri i shoqërisë së sigurimeve	PBP-ja e përgjithshme për të gjitha sigurimet e obligueshme	% pjesëmarrja në PBP për të gjitha sigurimet e obligueshme	Pjesëmarrje në Fondin Garantues
Trigllav	576.888.659	12,67%	23.370.686
Viner	527.344.000	11,58%	21.363.552
Unika	501.155.902	11,01%	20.302.630
Osiguritelna Polisa	465.387.833	10,22%	18.853.608
Sava	423.706.626	9,31%	17.165.036
Eurolink	414.352.662	9,10%	16.786.092
Evroins	406.174.085	8,92%	16.454.764
Halk osiguruvanje	367.091.294	8,06%	14.871.458
Grave jo-jetë	333.958.819	7,33%	13.529.208
Maqedonia	271.962.287	5,97%	11.017.629
Kroacia jo-jetë	265.162.000	5,82%	10.742.138
Gjithsej	4.553.184.167	100,00%	184.456.801

Burimi: Raporti i punës i BNS-së për 2019

Shoqëritë e sigurimeve të cilat kryejnë punë të obligueshme të sigurimeve nga autopërgjegjësia janë të detyruara të paguajnë mjete në Fondin Garantues në shumë proporcionale me primin e realizuar sipas klasave të veçanta të sigurimit të obligueshëm nga autopërgjegjësia në tremujorin paraprak, për tremujorin vijues gjatë vitit aktual.

Në përputhje me vendimin e Këshillit Drejtues të BNS-së, çdo vit kalendarik kryhet shpërndarje e re e mjeteve të Fondit Garantues në vlerë prej 3.000.000 denarësh, sipas përqindjes së pjesëmarrjes së shoqërisë së sigurimeve në primin e përgjithshëm të policës për të gjitha sigurimet e obligueshme. Për vitin 2019, pjesëmarrja në Fondin Garantues sipas shoqërive të sigurimeve është dhënë në Tabelën nr. 20.

3.3.2. Rimbursimi i dëmeve nga Fondi Garantues

Në përputhje me nenin 60 paragrafi 4 të Ligjit për sigurime të obliguara në transport, shoqëria e sigurimeve që ka kryer përpilim dhe pagesë të kërkesës për kompensim të dëmit, ka të drejtë të kthimit të mjeteve të paguara nga mjetet e Fondit Garantues.

Nga mjetet e Fondit Garantues nuk kompensohen dëmet e ndodhura nga përdorimi i mjeteve motorike të huaja të pasiguruara që qarkullojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse për të cilat vlejné marrëveshjet e veçanta ndërkombëtare të cilat nënshkruet është Republika e Maqedonisë së Veriut.

Tabela nr. 20: Dëme të paraqitura dhe të pranuar për rimbursim të Fondit Garantues për periudhën 01.01.2019- 31.12.2019

Emri i shoqërisë së sigurimeve	Numri i dëmeve të paraqitura për rimbursim	Numri i dëmeve të pranuar në Fondin Garantues	Dëme të pranuar në Fondin Garantues (dëme+gjendje) shuma në denarë
Maqedonia	104	100	21.007.647
Evroins	88	88	15.604.359
Unika	86	86	10.650.449
Grave jo-jetë	84	84	21.137.681
Osiguritelna polisa	81	81	8.676.990
Trigllav	78	78	12.550.334
Viner	69	69	7.267.209
Sava	65	65	10.366.454
Eurolink	61	61	7.580.773
Kroacia jo-jetë	52	52	8.242.231
Halk osiguruvanje	46	45	5.367.274
Gjithsej	814	809	128.451.401

Burimi: Raporti i punës i BNS-së për 2019

Në vitin 2019 në BNS nga shoqëritë e sigurimeve janë paraqitur 814 dëme për rimbursim, prej të cilave 809 dëme në shumë prej 129.451 milionë denarësh janë pranuar dhe rimbursuar.

Numri i dëmeve të paraqitura për rimbursim në Fondin Garantues në vitin 2019 (814) është zvogëluar me 39 dëme në krahasim me vitin 2018 (853), përkatësisht shënon zvogëlim prej 4,57%.

Dëmi mesatar i paguar në vitin 2019 është 158.778 denarë dhe ai shënon zvogëlim prej 0,18% në raport me dëmin mesatar të paguar në vitin 2018 (2018: 159.065 denarë).

Numri i dëmeve të paraqitura dhe të pranuar për rimbursim nga Fondi Garantues gjatë vitit 2019, si dhe shuma e dëmeve të pranuar janë dhënë në Tabelën nr. 21.

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve

Kërste Shajnoski

Numër 08-396/1

Shkup

19.06.2020